LIGJ
Nr. 102/2016

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 10 142, DATË 15.5.2009, "PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në titullin e ligjit, pas fjalëve "të Shërbimit Informativ të Shtetit" shtohen fjalët "të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

Neni 2

Në nenin 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve "të Shërbimit Informativ të Shtetit" shtohen fjalët "të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

b) Pas fjalëve "nr. 9357, datë 17.3.2005, "Për Shërbimin Informativ të Shtetit"" shtohen fjalët "nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes"".

Neni 3

Në nenin 2, pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në marrëdhënie pune me këtë agjenci, ata në lirim, me pagesë kalimtare dhe në pension.".

Neni 4

Në nenin 3, pika 1, pas fjalëve "nr. 9357, datë 17.3.2005, "Për Shërbimin Informativ të Shtetit"" shtohen fjalët "nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes"".

Neni 5

Në nenin 8, pas fjalëve "i Shërbimit Informativ të Shtetit" shtohen fjalët "i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

Neni 6

Në nenet 10, 11, 12, pika 1, 13, 15, 17 e 21, pas fjalëve "i/të SHISH-it" shtohen fjalët "i/të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

Neni 7

Në nenin 12, pika 4, shkronja "a", pas emërtesës "SHISH-i" shtohet emërtesa "Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

Neni 8

Në nenin 22, pas fjalëve "të Shërbimit Informativ të Shtetit" shtohen fjalët "të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9782, datë 31.10.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani